



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivered	27. 11	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	7120/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1247/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Percuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1247/2023 të datës 05.10.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1247/2023 e datës 05.10.2023, e parashtruar nga ankuesi.
- II. Anulohet Konkursi me numër Reference RN00010905, për emrin e grupit "Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës" i shpallur me datë 02.02.2023 nga Komuna e Prishtinës si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e pranimit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikë II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi me datë 05.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjen A.nr.1247/2023, lidhur me Konkursin me numër të referencës RN00010905, të shpallur me datë 02.02.2023 për pozitën e grupit " Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës", me pretendimet ankimore se të njëjtit i është bërë e pa drejtë me rastin e vlerësimit të resumes, po ashtu thekson se për pozitën të cilën ka aplikuar si Teknik i pylltarisë posedon përvojën adekuate përderisa kandidatët e pranuar për këtë pozitë as për së afërmi nuk i posedojnë aftësitë të cilat ky i posedon dhe atë; në fushën e planeve menaxhuese të pyjeve, rrallime para tregtare, pyllëzime si dhe ndërhyrjet silvikulturore në shfrytëzimin e pyjeve për të cilat pohon se është vlerësuar me note maksimale, po ashtu thekson se Këshillit i drejtohet lidhur me pretendimet etj. për shkeljen e procedurave të vlerësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit me datën 08.11.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 7010/2023, të datës 16.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1247/2023, të datës 05.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:6393/2023 të datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00010905 të datës 02.02.2023; Letër referencën nga JSG Group në Prishtinë të ankuesit së bashku me vlerësimin e performances së datës 27.02.2023; Referencën me numër PR/ APK-288/21 të datës 03.06.2021 të ankuesit nga Agjencia Pyjore e Kosovës; Referencën me numër 626/20 të datës 18.12.2020 nga Agjencia Pyjore e Kosovës; Vërtetimin e ankuesit me Nr.535/23 të datës 22.02.2023 nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara ne Ferizaj-Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit; Certifikatën mbi dënimet penale të ankuesit të datës 20.02.2023; Vërtetimin e ankuesit të datës 24.02.2023 nga Policia e Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; përgjigjen në ankesë të datës 08.11.2023 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 09.03.2023 nga Njësia e Personelit lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve pjesëmarrës; Njoftimin e datës 03.05.2023 nga Njësia e Personelit lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve pjesëmarrës; Njoftimin e datës 31.08.2023 të Komisionit të Vlerësimit; Rezultatet e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës të gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin e datës 06.09.2023 të Komisionit Vlerësues lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit; Njoftimin e datës 06.09.2023 te Komisionit Vlerësues për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin me numër 14-020/04-49772/23 të datës 07.03.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës lidhur me formimin e Komisionit të Pranimit; Diplomën e ankuesit me numër protokollit 880 të datës 24.09.2012 nga Shkolla e Mesme

e Lartë Profesionale "Abdyl Frashëri" në Prishtinë; Vërtetimin e datës 24.02.2023 nga Policia e Kosovës; Vlerësimin e performancës së ankuesit të datës 27.02.2023 nga Agjencia Pyjore e Kosovës si dhe Vendimin me numër protokoll 7010/2023 të datës 16.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon këtë qështje, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Prishtinës me datë 02.02.2023 ka shpallur Konkursin me numër Reference RN00010905, për emrin e grupit "*Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës*", për pozitën e punës "*Teknik i Pylltarisë për mbrojtje dhe Monitorim*" në Sektorin e Pylltarisë, klasa profesional 4, koeficient 5.5 të pagës, dy (2) vende pune.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 23.02.2023 deri me datë 02.03.2023, me ç' rast edhe ankuesi kishte aplikuar në këtë konkurs duke u përfshirë në të gjitha fazat e këtij procesi rekrutues, mirëpo që sipas vlerësimit përfundimtar (renditjes përfundimtare) të Komisionit të Pranimit të datës 31.03.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ, i njëjti ishte vlerësuar me gjithsejtë 55.2 pikë, duke u renditur si kandidati i tretë, rrjedhimisht kandidati ishte vlerësuar me gjithsej 73.8 duke u listuar si kandidati i parë, ndërsa kandidati është vlerësuar me 73 pikë, i renditur si kandidati i dytë.

Në funksion të shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave ligjore në fuqi përkitazi me procedurën e pranimit të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji mori për bazë Ligjin Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë (ligj ky i aplikueshëm me rastin e shpalljes dhe zhvillimit të procedurës së konkursit), ku me nenin 6 përcaktohet se: 1. *Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 2. *Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 3. *Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse).* 4. *Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike.* 5. *Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim.* 6. *Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.* 7. *Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi.* 8. *Testimi, vlerësimi dhe publikimi i rezulttit bëhet në mënyrë elektronike dhe sigurohet anonimiteti i konkurrentëve.* 9. *Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve sipas paragrafit 8 të këtij neni është 100 pikë, të cilat ndahen: 9.1. për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që ka të bëjë në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 20 pikë; 9.2. për testin me shkrim, deri në 70 pikë 9.3. për intervistën me gojë, deri në 10 pikë; 10. Kandidatët të cilët nuk i*

fitojnë 60% të pikëve nuk ftohen në intervistën me gojë". 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i Pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim: Lista e kandidatëve), e cila publikohet në ueb faqe...", Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 9 parasheh se: "1. Shpallja e një procedure konkurrimi publikohet nga Njësia Përgjegjëse në uebfaqen unike të procedurave të konkurrimit dhe emërimit, pjesë e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejme: "SIMBNJ"). 2. Përveçse përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, shpallja e konkurimit publikohet, sipas rastit edhe në: 2.1. ueb faqen e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, për konkurimet për pranimin në shërbimin civil në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe në uebfaqet e secilit institucion të administratës shtetërore si vegëz e veçantë e ndërlihdur me SIMBNJ apo në; 2.2. ueb faqen e Institucionit Tjetër Shtetëror për konkurimet për pranimin në këto institucione. . 3. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit, shpallet në një afat jo më të shkurtër se njëzetënjëditë (21) ditë kalendarike, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse. Afati për pranimin e aplikacioneve, nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe jo më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike ...", Neni 10 përcakton se: 1. Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitave, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët..." Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurimit 1. Konkurrimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 25 ka përcaktuar se: 1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezulttit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj 2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 4. Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezulttit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj...."

Në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji me këtë rast ka analizuar Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe ligjshmërinë e veprimeve procedurale që përbëjnë tërësinë e procesit të rekrutimit sipas Konkursit me numër Reference RN00010905, rrejdhimisht Kolegji nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit ka konstatuar se konkursi në fjalë është shpallur për emrin e grupit "Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës" lidhur me dy (2) pozitat "për Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim" ne Sektorin e Pylltarisë pranë Komunës së Prishtinës, për klasën e pozitës klasa profesional 4 e me koeficient të pagës 5.5, ku si kritere të përgjithshme formale

për këtë pozitë janë përcaktuar: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës se mesme apo ekuivalente me to; Kualifikime të posaçme formale: Shkolla e mesme, mirëpo preferohet shkolla e mesme bujqësore; Përvoja e punës së kërkuar: Nuk kërkohet dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komuna e Prishtinës konkursin në fjalë e ka shpallur në kundërshtim me nenin 13 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili ka përcaktuar se: "1. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1, Profesional 2, Profesional 3", ngase kjo e fundit pozitën në fjalë e ka shpallur për klasën e pozitës profesional 4 me koeficient të pagës 5.5, klasë kjo e cila nuk është e përfshirë (përcaktuar) fare sipas kësaj rregullore tek klasat e pozitës se nivelit profesional, ngase tek pozitat e nivelit të kategorisë profesionale janë të përfshira vetëm tri (3) klasa të pozitës dhe atë: Profesional 1, Profesional 2 si dhe Profesional 3 e që për këto klasa janë vendosur edhe kritere të ndryshme formale për zhvillimin e procedurës përkatëse, andaj me këtë rast Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Prishtinës gabimisht konkursin në fjalë e ka shpallur për kategorinë e klasës profesional 4, në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*


Andaj, Kolegji i Këshillit pas konstatimit se shpallja e konkursit për emrin e grupit "*Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës*" në Komunën e Prishtinës lidhur me dy pozitat për "*Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim*" në Sektorin e Pylltarisë pranë Komunës së Prishtinës është përfshirë me shkelje ligjore, vendosi që të anuloi Konkursin me numër reference RN00010905 dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga kjo procedurë pranimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit apo zhvillimit të procedurës nga se nuk ndikojnë në nxjerrjen e ndonjë vendim tjetër nga ky si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1247/2023, datë 27/11/2023

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.